

URDHËR
Nr. 59, datë 28.3.2025

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, dhe të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Brendshme, nga data 29.3.2025 deri më datë 1.4.2025, zëvendësministrit të Brendshëm, z. Julian Hodaj.
2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendësministri i Brendshëm, z. Julian Hodaj.
3. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit në Ministrinë e Brendshme për marrjen e masave të nevojshme për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Ervin Hoxha